

LIGJ
Nr.7683, datë 9.3.1993

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7527, DATË 11.12.1991 "PËR SHËRBIMIN USHTARAK
NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një deputeti,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7527, datë 11.12.1991 "Për shërbimin Ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", pas nenit 24 shtohet neni 24/a me këtë përmbajtje:

"Studentët që kanë mbaruar dhe që do të mbarojnë shkollat e larta me shkëputje nga puna deri më 1 shtator 1994, perjashtohen nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.490, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.